



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2023:195786  
Datë: 16.01.2024  
Numri i dokumentit: 05195672

**PA1.nr.1597/23**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS - Departamenti i Pergjithshem**, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Ferit Osmani, kryetar i kolegjit, Abdullah Ahmeti dhe Zyhdi Haziri, anëtarë, me praktikantin gjyqesor Arben Arifi, si procesmbajtës në lëndën penale ndaj të akuzuarit K.M., nga Mitrovica, për shkak të veprës Lëndimi i lehtë trupor nga neni 185 par.3 nën par.3.1 e lidhur me par.1 nën par.1.4 të KPRK-së, për të vendosur sipas ankesës së mbrojtëses se të akuzuarit, të ushtruar kundër aktgjyqimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë, P.nr. 419/2023 të datës 27.11.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 11 Janar 2024 mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

**Me aprovimin** e ankesës së mbrojtëses se të akuzuarit K.M., ndryshohet aktgjyqimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë, P.nr. 419/2023 të datës 27.11.2023, ashtu që Gjykata e Apelit e Kosovës për veprën penale për të cilën është shpallur fajtor, i shqipton dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 5 (pesë) muaj, e në të cilin dënim do t'i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim nga data 13.09.2023 e tutje por jo më shumë se dënimi i shqiptuar.

Ne pjesën tjetër aktgjyqimi i ankimuar i Gjykatës së shkallës së parë mbetet i pandryshuar.

**A r s y e t i m**

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore Mitrovicë, P.nr. 419/2023 të datës 27.11.2023, i akuzuari K.M., është shpallur fajtor për shkak të veprës Lëndimi i lehtë trupor nga neni 185 par.3 nën par.3.1 e lidhur me par.1 nën par.1.4 të KPRK-së, për të cilën i është shqiptuar dënimi burgim në kohëzgjatje prej 8 (tetë) muaj, e në të cilin dënim i është

Ilogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim nga data 13.09.2023 e deri ne plotfuqishmërinë e aktgjykimit por jo më shumë se dënimi i shqiptuar.

I akuzuari është obliguar që të paguaje shpenzimet e procedurës penale që dalin sipas llogarisë përfundimtare të Gjykatës, në emër të paushallit gjyqësor shumën prej 30 (tridhjetë) euro, si dhe për taksen për kompensimin e viktimave të krimit shumën prej 20 (njëzet) euro si dhe në emër të ekspertizës mjeko-ligjore shumën prej 20 (njëzet) euro e të gjitha këto në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Pala e dëmtuar A.S., për realizimin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar në kontest të rregullt civil.

### **Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ankesë ka ushtruar :**

Mbrojtësja e të akuzuarit K.M. – Av.Nadire Koshi nga Mitrovica, për shkak të vendimit mbi sanksionin penal, duke propozuar që aktgjykimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë të ndryshohet dhe të akuzuarit për veprën penale për të cilën është shpallur fajtor t'i shqiptohet një dënim më i ulët se sa dënimi i shqiptuar nga ana e gjykatës së shkallës së parë me të cilin dënim do të arrihej qëllimi i dënimit i parapare me neni n 38 të KPRK-së

Prokurori i Apelit i Kosovës, duke u shkjaruar përkitazi me ankesën e mbrojtëses së të akuzuarit K.M., me shkresën e vet PPA.II.nr. 1630/2023 të datës 18.12.2023 ka propozuar që Gjykata e Apelit e Kosovës, ankesën e mbrojtëses së të akuzuarit ta refuzojë si të pabazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar i Gjykatës së shkallës së parë të vërtetohet.

Gjykata e Apelit mbajti seancën e kolegjit në pajtim me nenin 390 paragrafi 1 të KPPRK-së, në të cilën prezantuan i akuzuari K.M. si dhe mbrojtësja e tij av.Nadire Koshi nga Mitrovica si dhe interpretja e gjuhës së shenjave D.S., ndërsa mungoi Prokurori i Apelit si dhe e dëmtuara A.S. edhe pse të njoftuar në mënyrë të rregullt, andaj seanca e kolegjit u mbajt në pajtim me nenin 390 par.4 të KPRK-së. Mbrojtësja e të akuzuarit në tërësi mbeti pranë ankesës së parashtruar me shkrim dhe pas elaborimit të së njëjtës propozoi që të akuzuarit të i shqiptohet një dënim më i ulët me e sidomos nga arsyeja se i njëjti është person me aftësi gjysmë të kufizuara në të folur. I akuzuari nëpërmes interpretes i përkrahu fjalët e mbrojtëses së tij dhe shprehu keqardhje për rastin e ndodhur.

Kolegji penal i Gjykatës së Apelit të Kosovës, konform nenit 394 par.1 të KPPK-së i shqyrtoi shkresat e lëndës, vlerësoi aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore të mbrojtëses së të akuzuarit K.M., dhe gjeti se :

#### **- Ankesa është e bazuar.**

Edhe pse aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë nuk ankimohet për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, megjithatë Gjykata e Apelit e Kosovës të njëjtin e shqyrtoi në këtë aspekt sipas detyrës zyrtare konform nenit 394 të KPPRK-së dhe konstatoi se nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, e as shkelje të ligjit penal e të cilat kishin me kushtëzuar anulimin e tij.

As gjendja faktike nuk ka qenë objekt shqyrtimi ngase i akuzuari gjatë shqyrtimit fillestar të datës 03.11.2023 në bazë të nenit 242 të KPRK-së ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën është akuzuar, i cili pranim është bërë në mënyrë vullnetare nga i akuzuari,

pas konsultimit të mjaftueshëm me mbrojtësen e tij. Pranimi i fajësisë ka mbështetje në faktet që përmban aktakuza dhe provat që gjenden në shkresat e lëndës. Nga një gjendje e tillë e vërtetuar faktike del që në rastin konkret drejtë është aplikuar edhe ligji penal.

Sa i përket vendimit mbi sanksionin penal, mbrojtësja e të akuzuarit K.M. – Av.Nadire Koshi, me ankesë pretendon se Gjykata e shkalles së parë me rastin e shqiptimit të dënimit me burgim, nuk i ka vlerësuar drejte dhe në mënyre të duhur rrethanat lehtësuese si faktin se i akuzuari në fazat e hershme të procedurës e ka pranuar fajësinë për veprën penale të kryer, ka shprehur keqardhje, ka premtuar se në të ardhmen nuk do të kryejë vepra penale, se i njëjti është person me aftësi gjysmë të kufizuara në të folur, e sikur këto rrethana të ishin vlerësuar në mënyre të duhur është dashur që të akuzuarit të i shqiptohet një dënim me i ulët me burgim, e me të cilin dënim do të arrihej qëllimi i dënimit i parapare me nenin 38 të KPRK-se, andaj ka propozuar që ankesa e mbrojtëses së të akuzuarit të aprovohet si e bazuar.

Gjykata e Apelit i vlerësoi pretendimet ankimore të mbrojtëses së të akuzuarit lidhur me sanksionin penal dhe duke i pasur parasysh rrethanat e cekura më lartë dhe rrethanat e rastit konkret dhe pas vlerësimit të pretendimeve ankimore të mbrojtëses së të akuzuarit, konstaton se gjykata e shkalles së parë përkundër se në mënyrë të drejtë dhe të plotë i ka vlerësuar rrethanat lehtësuese dhe rënduese nga neni 69 dhe 70 të KPRK-se të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, konstatoi se ka vend që të akuzuarit të i shqiptohet një dënim më i ulët me burgim se sa dënimi i shqiptuar e sidomos nga fakti se i akuzuari është person me aftësi të kufizuara në të folur e që kjo është konstatuar edhe nga prezenca e interpretues dhe komunikimit të se njëjtës me të akuzuarin, andaj e ndryshoi aktgjykimin e shkalles së parë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke e ulur dënimin me burgim, e me bindje se me dënimin e shqiptuar nga ana e Gjykatës së Apelit, do të arrihet qëllimi i dënimit i parapare me nenin 38 të KPRK-së, respektivisht parandalimi i kryerësit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, të bëhet rehabilitimi i tij, parandalimi i personave tjerë nga kryerja e veprave penale dhe ngritja e moralit për respektimin e ligjit.

Nga arsyet e cekura më lartë, e në bazë të nenit 403 të KPPK-së u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**  
**PA1.nr.1597/23 më 11.01.2024**

**Procesmbajtësi**  
**Arben Arifi**

**Anëtarët e kolegjit**  
**Abdullah Ahmeti**

**Kryetar i kolegjit**  
**Ferit Osmani**

**Zyhdi Haziri**